

# Shpallet 1 pozicion pune pranë Qendrës së Pritjes për Azil (QPA) – Afatet, dokumentacioni

Në mbështetje të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në RSH”, i ndryshuar, neni 19 pika 1, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”; të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij; të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij

**Qendra e Pritjes për Azil (QPA) shpall 1 vend vakant:**

**1. Specialist Përkthyes - Klasa e pagës IV-3**

## **QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS**

Lehtësimi i procesit të komunikimit midis palëve azilkërkuese dhe punonjësve që nuk flasin të njëjtën gjuhë.

## **DETYRAT KRYESORE**

1. Përkthyesi kryen përkthimin profesional të materialeve nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas, në formën e shkruar ose jo, sipas kërkesave duke qenë përgjegjës për cilësinë dhe saktësinë e përkthimeve
2. Siguron dhe ofron shërbime të përkthimeve me shkrim të dokumenteve juridike, formularëve, udhëzimeve administrative, udhëzuesve, raporteve,deklaratave dhe materialeve tjera nga gjuha shqipe ne gjuhen angleze dhe anasjelltas.
3. Përgjegjës për ruajtjen e konfidencialitetit të dokumenteve dhe shkresave të cilat i përkthen, duke mos komentuar për të njëjtat në punë dhe jashtë vendit të punës.
4. Ndihmon procesin e komunikimit midis QPA dhe institucioneve të tjera.
5. Kryen detyra të tjera të caktuara nga titullari i institucionit, që nuk janë në kundërshtim me ligjet dhe nuk çenojnë dinjitetin e punonjësit.

## **Kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët për këtë pozicion:**

Kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët për këtë pozicion:

*Kritere të përgjithshme:*

- a) të ketë integritet të lartë dhe moral;
- b) të jetë shtetas shqiptar;
- c) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje,;
- dh) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriteve të miratuara.

*Kritere të posaçme:* Të plotësojë kërkesat për Arsimin e lartë Bachelor (Master Profesional ose Shkencor).

Përvoja: 1 vit përvojë pune.

Tjetër: Aftësi për të organizuar punën komplet autonome, duke përcaktuar përparësitë, të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse dhe respektuar limitet e caktuara. Aftësi për të punuar në situata stresuese, aftësi për t'u adaptuar në ambiente dhe kultura të ndryshme pune..

## **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit të aplikimeve**

- Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet:
- Kërkesë për punësim/Letër motivimi dhe CV;
- Diplome e shkollës së lartë të noterizuar, së bashku me listë notash;
- Fotokopjet të patentës nëse ka;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Dëshmi Penaliteti;

- Vërtetim nga institucioni/punëdhënësi që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Mosdorëzimi i dokumenteve të mësipërme dhe mosplotësimi i kriterëve, e skualifikojnë automatikisht aplikantin.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, duhet të bëhet brenda datës **13.07.2023**, dorazi në protokollin e Qendrës së Pritjes për Azil, me adresë Rr. “Myslym Keta”, Babrru, Tiranë.

Zhvillimi i intervistës me aplikantët e përzgjedhur nga komisioni “ad-hoc” brenda datës **14 Korrik 2023**, pranë Qendrës së Pritjes për Azil si dhe njoftimi i kandidatëve të suksesshëm brenda datës **14 Korrik 2023**.

Vetëm kandidatët të cilët përmbushin kriteret do të përzgjidhen dhe do të njoftohen për intervistë pranë Qendrës së Pritjes për Azil. Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.